



## **VENDIMI MBI PRANUESHMËRINË DHE MERITAT**

**Data e miratimit: 18 gusht 2022**

**Nr. i lëndës: 2016-29**

**Sladana Savić**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 18 gusht 2022, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Snježana BOKULIĆ, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit  
Z. Petko PETKOV, anëtar

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike në përputhje me rregullën 13(3) të rregullores së punës së Panelit, vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURA PRANË PANELIT**

1. Kjo ankesa është regjistruar më 22 shtator 2016.
2. Më 29 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ankuesja që të ofrojë informata shtesë lidhur me ankesën e saj. Ankuesja nuk iu përgjigj asaj letre.
3. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia transmetoi një deklaratë faktesh dhe pyetjesh shefit të Misionit ("ShM"), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar Misionin që të dorëzojë përgjigje dhe vërejtje me shkrim mbi ankesat deri më datën 26 janar 2018.
4. Me letrën e datës 17 janar 2019, Misionit iu kërkua që të japë përgjigje pyetjeve deri më datën 16 shkurt 2019.
5. Me letrën e datës 8 prill 2019, Misionit iu kërkua sërish që të japë përgjigje për pyetjet sa më shpejt të jetë e mundur.
6. Me letrën e datës 20 qershor 2019, ankuesi është informuar se rasti i është komunikuar Misionit dhe lënda është ende në shqyrtim e sipër.

7. Me letrën e datës 18 shtator 2020, Paneli e informoi Misionin se, me qëllim të përshpejtimin të procedurave, Paneli synonte të merrej me çështjet e pranueshmërisë dhe meritave në të njëjtën kohë në një vendim të vetëm. Për këtë qëllim, Paneli e ftoi Misionin që të paraqesë parashtresat e tij në lidhje me meritat në ato raste kur ai kishte dhënë tashmë komentet e tij mbi pranueshmërinë.
8. Më 17 janar 2022, ShM-ja dorëzoi vërejtjet e tij mbi rastin.
9. Më 31 janar 2022, letra e ShM-së iu dorëzua për informim ankueses, të cilës iu dha kohë deri më 7 mars 2022 për të bërë ndonjë parashtrim të mëtejshëm në përgjigje të asaj letre. Ankuesja nuk ka dhënë përgjigje.
10. Nuk u pranuan parashtresa të tjera në këtë rast.

## **II. PËRBËRJA E PANELIT**

11. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të tij të jashtëm, Paneli do të mbliidhet për këtë çështje me vetëm dy anëtarë në përputhje me rregullën 14 të rregullores së punës së Panelit.

## **III. FAKTET**

12. Faktet e lëndës, siç dalin nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë.
13. Më 10 korrik 1999, bashkëshorti i ankueses, Staniša Stojanović, ishte zhdukur në komunën e Vitisë, rajoni i Gjilanit.
14. Në të njëjtën ditë - 10 korrik 1999, ankuesja e raportoi zhdukjen e bashkëshortit të saj në KFOR dhe UNMIK.
15. Në orët e pasdites, ankuesi raportoi zhdukjen në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK).
16. Që nga ajo ditë, ankuesja asnjëherë nuk është kontaktuar nga asnjë autoritet dhe as nuk ka marrë ndonjë informacion për bashkëshortin e saj.
17. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2005, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës ka lëshuar një raport hetimor ante-mortem në lidhje me dy persona, njëri prej të cilëve ishte bashkëshorti i ankueses.
18. Ankuesi nuk ishte i informuar për këtë dhe lënda ishte mbajtur "e hapur".
19. Dokumentet e dorëzuara nga UNMIK-u nuk përmbajnë informacion se çfarë hapash hetimor, nëse ka pasur, janë kryer nga UNMIK-u.

## **IV. ANKESA DHE QËNDRIMI**

20. Ankuesja pretendon se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë hetim për zhdukjen dhe vrasjen e bashkëshortit të saj që ishte zhdukur në korrik të vitit 1999.
21. Paneli konsideron se ankesa ka të bëjë me të paktën dy të drejta të veçanta themelore të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të

Drejttave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), e cila garanton të drejtat themelore të personit për jetë dhe nën drejtimin e tij procedural, parashikon detyrimin për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; dhe neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues.

22. Përveç kësaj, ankesa mund të jetë e rëndësishme për të drejtat e parashikuara në nenet 8 dhe 13 të së njëjtës Konventë, të cilat garantojnë, përkatësisht të drejtën për jetë familjare dhe të drejtën për një zgjidhje efektive për këdo, të drejtat dhe liritë e të cilit parashikohen në Konventë janë shkelur. Të njëjtat të drejta mbrohen nga një sërë traktatesh të tjera ndërkombëtare, përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.
23. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare ndërmjet viktimës kryesore – Staniša Stojanović – dhe ankueses – Slađana Savić (bashkëshorti dhe bashkëshortja) – Paneli është i bindur se ankuesi mund të konsiderohet viktimë dytësore e shkeljeve të supozuara dhe se, si e tillë, një viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

## V. PARASHTRIMET E PALËVE LIDHUR TË PRANUESHMËRISË

### Ankuesi

24. Siç është përmbledhur më lart, ankuesja pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë është dashur të hetojë zhdukjen dhe vrasjen e bashkëshortit të saj dhe me faj ka dështuar ta bëjë këtë duke shkelur të drejtat themelore të saj dhe të bashkëshortit të saj. Sipas deklaratës së saj, ajo kurrë nuk është informuar për vendndodhjen e bashkëshortit të saj.

### Shefi i Misionit (“HoM”)

25. Në letrën përcjellëse të parashtresave të tij, ShM-ja tregon se mund të ketë informacione në posedim të Komisionit serb për persona të zhdukur në lidhje me ekzistencën e një trupi që supozohet se i përket bashkëshortit të ankuesit.
26. ShM-ka gjithashtu tregon se, në kuadër të dorëzimit të rasteve dhe dosjeve nga UNMIK-u tek EULEX-i në periudhën dhjetor 2008 deri në mars 2009, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës – NJHKL e EULEX-it ka pranuar dokumente në lidhje me zhdukjen e Staniša Stojanović-it. Në momentin e dorëzimit nga UNMIK-u tek EULEX-i, rasti i Staniša Stojanović-it ishte përfshirë në Njësinë e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut – NJPZH-ja në bazën e të dhënave të personave të zhdukur dhe kishte statusin “i hapur”.
27. Në veçanti, Misioni thekson se,

“Si pjesë e transferimit nga Policia e UNMIK-ut, Njësia e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës – NJHKL mori një raport hetimor ante-mortem të UNMIK-ut nga viti 2005, duke iu referuar dy personave të zhdukur, përfshirë Staniša Stojanović (potencialisht duke i përzier të dy rastet), duke treguar se asnjë dëshmitar nuk ishte intervistuar dhe se informacioni në dispozicion ishte mbledhur nga baza e të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare”.
28. Në lidhje me dosjet dhe kategorizimin e lëndëve nga UNMIK-u në EULEX, Misioni tregon se përveç dosjeve të lëndëve që EULEX-i i ka pranuar nga UNMIK-u në vitet 2008-2009, ka pasur edhe disa baza të të dhënave në Microsoft Access që ishin dorëzuar. Këto përfshinin një në lidhje me dosjet policore të “krimeve të luftës” dhe një tjetër në lidhje me

rastet e "personave të zhdukur". Dosja e Staniša Stojanovićit ishin të zbrazëta në bazën e të dhënave të dytë, për shkak të informacionit se ai kishte vdekur.

29. Lidhur me masën në të cilën Misioni ndërmori hapa për të identifikuar dhe hetuar rastet e zhdukjeve me forcë dhe/ose vrasjeve, Misioni *ndër të tjera* thekson se,

"Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, në fuqi në kohën e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale, nuk përmbante ndonjë referencë eksplicite për 'zhdukjet me forcë'. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (REGJ. UNMIK 2003/25) dhe Kodi Penal i Kosovës (Nr. 04/L-082) që e zëvendësuan atë, si dhe Kodi aktual Penal i Kosovës (Nr. 06/L-074), i referohet zhdukjeve me forcë si një nga veprat penale, të cilat, në rrethana të caktuara, mund të përbëjnë krime kundër njerëzimit, jo krime lufte. Zhdukjet me forcë gjithashtu nuk ishin parashikuar sipas ligjit penal të zbatueshëm në Kosovë gjatë dhe menjëherë pas konfliktit, duke përfshirë Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976. EULEX-i, megjithëse në mënyrë indirekte, ka hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e zhdukjeve me forcë në kuadër të rasteve të krimeve të luftës".

30. Lidhur me përfshirjen e organeve të EULEX-it në rastin konkret, Misioni thekson se,

"Policia e EULEX-it nuk ka kontaktuar autoritetet e UNMIK-ut në lidhje me këtë rast. Megjithatë, Ekipi i Mjekësisë Ligjore të EULEX-it ka qenë në kontakt me Komisionin serb për Persona të Zhdukur në shumë raste duke përfshirë dy vitet e fundit dhe shpreson që ankuesja do të kontaktohet nga këto autoritete në periudhën e ardhshme dhe do t'i sigurohet informacione për bashkëshortin e saj".

31. Misioni gjithashtu tregon se,

"[...] një vlerësim i drejtë i sjelljes së EULEX-it sipas pjesës procedurale të nenit 2 dhe sipas nenit 3 të Konventës në lidhje me këtë rast specifik, duhet të marrë parasysh përmasat e sfidës së paraqitur nga numri shumë i lartë i krimeve si dhe kontekstin dhe rrethanat në të cilat Misioni ishte thirrur për të zbatuar mandatin e tij".

32. Në parastresat e tij në lidhje me këto dispozita, Misioni merr parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në raste të ngjashme dhe nuk konteston pranueshmërinë e kësaj ankese sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **VI. VLERËSIMI I PANELIT LIDHUR ME PRANUESHMËRIN E LËNDËS**

*Mandati i Panelit (rregulla 25, paragrafi 1, i rregullores së punës) dhe kufizimet e aplikueshme për Misionin në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.*

33. Siç u përmend më lart, ShM-ja nuk e kundërshton pranueshmërinë e këtij rasti.

34. Pas shqyrtimit të kërkesave përkatëse të pranueshmërisë, Paneli është i bindur se rasti është vërtet i pranueshëm.

## VII. PARASHTRIMET E PALËVE LIDHUR ME MERITAT E LËNDËS

### Ankuesja

35. Siç u përmend më lart, ankuesja pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë është dashur të hetonte zhdukjen e bashkëshortit të saj dhe të ndiqte penalisht autorët, dhe se EULEX-i me faj nuk ka bërë këtë duke shkelur parimet themelore të saj dhe të drejtat e bashkëshortit të saj. Paneli ka përcaktuar më lart se ankesa këtu duhet të shqyrtohet në bazë të neneve 2 (pjesa procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### Shefi i Misionit

36. Misioni në parashtrirat e tij ka përshkruar disa nga sfidat praktike të lidhura me hetimin e këtij lloji të rasteve dhe ka pranuar se menaxhimi i dosjeve që kishte marrë nga UNMIK-u ka qenë veçanërisht sfidues.
37. Misioni ka sqaruar se sipas mandatit aktual EULEX-i nuk është i autorizuar të zbulojë informacione mbi hetimet që janë në vazhdim e sipër që i ka marrë gjatë aktiviteteve të tij monitoruese. Misioni parashtron se,

“Prandaj, kur i fton ankuesit që të kontaktojnë institucionet kompetente, Misioni thjesht po i referon ata tek autoritetet që, sipas ligjit, janë kompetente dhe të autorizuar për t’iu dhënë atyre informacion në lidhje me çfarëdo hapi hetimor që mund të kenë ndërmarrë që nga fundi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale në qershor 2018”.

38. Në lidhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut, Misioni rikujton se:

“[...] detyrimi procedural sipas nenit 2 i [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është “sipas mjeteve” e jo “sipas rezultateve”. E rëndësishme në vlerësimin e zbatimit të tij është se “autoritetet kanë bërë gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tyre në bazë të rrethanave të rastit”. (Shih, për shembull, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) *Trivkanović kundër Kroacisë*, nr. 12986/13, Aktgjykimi i datës 6 korrik 2017, paragrafi 78, *Borojević dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr.70273/11, Aktgjykimi i datës 4 prill 2017, par. 57; Aktgjykimi i datës 9 prill 2015, par. 69).

39. Përveç kësaj, Misioni kujtoi se,

“[...] natyra dhe shkalla e hetimit duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me realitetin praktik të punës hetimore’. (Shih, për shembull, GjEDNj *Cindrić dhe Bešlić kundër Kroacisë*, nr. 72152/13, Aktgjykimi i datës 6 shtator 2016, par. 69, *Zdjelar dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 80960/12, Aktgjykimi i datës 6 korrik 2017, par. 83; *Velcea dhe Mazare kundër Rumanisë*, nr.64301/01, Aktgjykimi i datës 1 dhjetor 2009, paragrafi 105; dhe *Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5878/08 5878/08, Aktgjykimi i datës 30 mars 2016, par. 234).

40. Misioni gjithashtu ka pohuar se,

“Siç pranohet në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Panelit, si dhe në praktikën gjyqësore përkatëse të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut, pritshmëritë mbi aftësinë e një misioni për sundimin e ligjit siç është EULEX-i për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet siç është ky aktual duhet të jenë 'realiste'

dhe 'proporcionale'. Një vlerësim i asaj që është "realiste" dhe "proporcionale" në lidhje me një rast të vetëm, duhet të marrë parasysh "të gjitha faktet relevante" dhe "realitetet e punës hetimore" siç përshkruhet në parashtresat e Misionit".

41. Në veçanti, Misioni ka pohuar se,

"Sipas "Librit Kujtimi i Kosovës" i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë, më shumë se 13,000 individë nga të cilët mbi 10,000 civilë, janë vrarë ose janë zhdukur në periudhën 1998-2000. Shkalla e krimeve të kryera nënkupton që pritshmëritë për aftësinë e një misioni për sundimin e ligjit siç është EULEX-i për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto raste duhet të jenë realiste dhe proporcionale".

42. Prandaj, Misioni ka pretenduar se,

"Paaftësia për të hetuar një zhdukje të pretenduar me forcë nuk mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut, kur dështimi për të hetuar materializohet në një kontekst krimesh në shkallë të gjerë që përfshijnë mijëra viktima dhe ku është e qartë se asnjë autoritet hetues nuk mund të pritët që të zgjidhë të gjitha rastet e ngritura para tij. Kjo konsideratë zbatohet edhe më shumë (*a fortiori*) për një situatë ku autoriteti përgjegjës nuk është shtet, por mision ndërkombëtar, me burime të kufizuara në dispozicion dhe me mandat të kufizuar në kohë (që nga fillimi i tij në vitin 2008, mandati i EULEX-it është zgjatur çdo dy vjet)".

43. Misioni gjithashtu ka pranuar se,

"[...] menaxhimi i dosjeve të trashëguara nga UNMIK-u ishte një sfidë dhe se [Misioni] nuk ishte në gjendje të korigjonte shumë mospërputhje dhe dublikime. Ai gjithashtu pranon se njësitë e tij të policisë dhe prokurorisë duhet të kishin siguruar komunikim më të mirë me viktimat dhe të afërmit e viktimave, si dhe me publikun e gjerë. Megjithatë, ai pohon se do të ishte thjesht joproporcionale të pritej që Misioni të hetonte të gjitha vrasjet, vdekjet dhe zhdukjet e dyshimta dhe të rihapte rastet që tashmë kishin përfunduar nga autoritetet e UNMIK-ut".

44. Misioni ka theksuar më tej se,

"[...] nuk konteston që ankuesja ka të drejtë të dijë se çfarë i ka ndodhur burrit të saj dhe është i gatshme të vazhdojë të mbështesë institucionet e Kosovës dhe Serbisë në sqarimin e fatit të tij në përputhje me mandatin e tij aktual."

45. Misioni ka parashtuar se rrethanat në të cilat EULEX-i ishte thirrur për të zbatuar mandatin e tij kërkonin prioritizimin e disa rasteve mbi të tjerat. Megjithatë, Misioni ka pranuar në parashtresat e tij se njësitë e tij të policisë dhe prokurorisë mund të kishin siguruar komunikim më të mirë me viktimat dhe të afërmit e tyre dhe të mbante publikun e gjerë të informuar për strategjitë dhe qasjet e tij, për të menaxhuar pritjet në mënyrë më adekuate dhe për të qenë më shumë transparent.

46. Megjithatë, Misioni ka pohuar se në rastin në fjalë dhe duke marrë parasysh pengesat themelore me të cilat ishte paraqitur, nuk konsideron se të drejtat e ankueses janë shkelur.

## Parashtresat në përgjigje

47. Më 31 janar 2022, parashtresat e Misionit për meritat e rastit iu ishin përcjellë ankueses, e cila ishte ftuar të dorëzonte komentet e saj mbi meritat e rastit, nëse ka pasur, jo më vonë se data 7 mars 2022.
48. Nuk u pranuan parashtresa të tjera në këtë rast.

## VIII. VLERËSIMI I PANELIT LIDHUR ME MERITAT E KËTIJ RASTI

### Konsiderata të përgjithshme

49. Misionit iu kërkua që t'i përmbushë përgjegjësitë e tij ekzekutive në një mënyrë që është në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. *Ndër të tjera* kjo nënkuptonte se Misioni do të hetonte rastet brenda kompetencës së tij juridikionale që përfshinin shkeljen e të drejtave të garantuara sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Lidhur me standardet ligjore përkatëse të aplikueshme shih: PShDNj-në, *Shënim i praktikës gjyqësore mbi detyrimin për hetimin e pretendimeve për shkelje të të drejtave*, f. 3-5 (dhe praktikën gjyqësore të cituar); dhe *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 36; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmëri, 30 shtator 2015, par. 88; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 58. Shih gjithashtu GjEDNj-së: *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i dates 6 korrik 2005, par. 110; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi 4 maj 2001, par. 105; *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i datës 27 shtatorit 1995, Seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i datës 28 tetor 1998, Raportet e aktgjyqimeve dhe vendimeve 1998-VIII, par. 102.
50. Gjithashtu është kërkuar që Misioni t'i mbajë të afërmit e të zhdukurve të informuar në mënyrë adekuate për përpjekjet e tij për të hetuar këtë rast. PShDNj-ja, *Shënim gjyqësor mbi detyrimin për të hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave*, f. 28-30 (dhe praktika gjyqësore e cituar); dhe *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 61-63; *U.F. Kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 97; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, *Vendimi dhe Gjetjet, Lënda nr. 2016-17, 4 qershor 2019, para 55*; *S.H. kundër EULEX-it*, *Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66*; *Desanka and Zoran Stanisić against EULEX*, 2012-22, 11 November 2015, par. 66; shih gjithashtu Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 prill 2004, par. 311-314; *Isayeva kundër Rosisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 24 shkurt 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës korrikut 2011, par. 167).
51. Rasti në fjalë, si dhe rastet e tjera të zhdukjes/personave të zhdukur me forcë, bien pikërisht brenda fushëveprimit të atyre kompetencave dhe përgjegjësi.
52. Misioni parashtron një numër argumentesh në përpjekje për të shpjeguar dështimin e tij për të hetuar rastin aktual (dhe raste të tjera të ngjashme) dhe për të mbajtur të informuar siç duhet familjarët e të zhdukurve në këtë rast.

53. Paneli thekson se shumica e atyre argumenteve tashmë janë ngritur dhe refuzuar në rastet e mëparshme të të njëjtit lloj. Prandaj, Paneli do të kufizojë konsideratat e tij për ato argumente në atë që është e nevojshme vetëm për zgjidhjen e këtij rasti.

#### **Sfidat që lidhen me hetimin e personave të zhdukur/rastet e zhdukjeve me forcë**

54. Shefi i Misionit sugjeron që sjellja e Misionit në lidhje me rastet individuale duhet të merret parasysh në bazë të sfidës së përgjithshme, që hetimi i të gjitha rasteve të personave të zhdukur ka përfaqësuar për Misionin. Paneli e ndan këtë pikëpamje vetëm deri në një pikë.
55. Siç e ka pranuar në mënyrë të përsëritur Paneli, është e saktë se detyra me të cilën përballej Misioni ishte shqetësuese. Në fillim të mandatit të tij, Misioni kishte me qindra raste që përfshinin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut për t'i hetuar. Është gjithashtu e saktë që burimet e tij – në ekspertizë, financa dhe personel – ishin të kufizuara. Për më tepër, këto hetime të vështira kryheshin vetëm me mbështetje të kufizuar nga autoritetet vendore dhe në një situatë pas konfliktit që do ta bënte një situatë të vështirë edhe më sfiduese. Për më tepër, dosjet e Misionit të trashëguara nga UNMIK-u ishin mbajtur dhe organizuar në mënyrë të dobët. Kjo kërkonte që Misioni të kryente vetë rishikimin e përsëritur të atyre dosjeve. Lidhur me këto vështirësi, shih gjithashtu: *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 60; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 43-45; *A,B,C,D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K deri në T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 72-74; shih gjithashtu Vendimin e Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj) në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe paragrafët 70-71.
56. Megjithatë argumentimi i përfshirë në parashtresën e shefit të Misionit duke theksuar kufizimet e tij nuk ka të bëjë me këtë rast konkret. Përkundrazi, kjo pasqyron mangësitë sistemike të Misionit, duke përfshirë këto: mungesën e përgjithshme të planifikimit të duhur për hetimet dhe ndjekjet penale; mungesën e politikës së prioritizimit të rasteve; mungesën e fokusimit në rastet që përfshijnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut; mungesën e hetimeve të shpejta dhe efektive; në përgjithësi mosinformimin e të afërmeve të personave të zhdukur; politikën jo të qartë për rastet e zhdukjeve me dhunë dhe si rrjedhojë mos prioritizimin e tyre; numrin e vogël të rasteve të “zgjidhura” në lidhje me personat e zhdukur; mbështetjen e paarsyeshme në dosjet dhe vendosmërinë e UNMIK-ut (shih, p.sh. *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 45-47; *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Gjetjet dhe Vendimi, Vendimi dhe Pranueshmëria 11 dhjetor 2020, paragrafët 80-84); praktika të dyshimta nga stafi i prokurorisë (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 Prill 2013, paragrafët 34-35; *F. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, 2011-27, Vendimi dhe Gjetjet, 5 dhjetor 2017, paragrafët 60-63); aktet e kryera pa bazë të qartë ligjore (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 prill 2013, paragrafët 41-43; *G.T. kundër EULEX-it*, 2019-01, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, par. 70); moskërkimin e të dhënave përkatëse nga burimet e mundshme të informacionit (p.sh., KNKK; autoritetet serbe; OSBE). Këta faktorë dhe të tjera janë të dukshme në rastet që janë parashtruar në Panel. Këto nuk janë pasoja të sfidave që lidhen me mandatin e Misionit ose me mungesën e burimeve. Ato janë pasojë e planifikimit të dobët, menaxhimit joadekuat operacional të hetimeve dhe ndjekjeve penale, mungesës së politikës së qartë të prioritizimit të rasteve, mos vendosjes së një sistemi komunikimi me të afërmit e personave të zhdukur dhe mospasjes së një politike të qartë hetimore dhe prokuroriale në lidhje me këto lloje të rasteve. Këto gjithashtu demonstrojnë paaftësi nga ana e Misionit



për të siguruar që planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të tij vazhdimisht të kenë parasysh obligimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut.

57. Paneli dëshiron të theksojë kalimthi se Misioni e kuptoi tashmë gjatë procesit të transferimit se kushtet e dosjeve të transferuara ishin larg nga të qenurit të duhura. Prandaj, Misioni duhej të ishte paralajmëruar se duhet pasur nevojë të afrohet dhe të mbështet te ato shënime me kujdes. Njohuritë e Misionit për sfidat e lidhura me dosjet duhet ta kishin paralajmëruar atë për nevojën për të siguruar që aftësia e tij për të përmbushur obligimet e veta nuk do kishte ndikuar negativisht nga ato shënime. Si mision ndërkombëtar i sapo themeluar, EULEX-i Kosovë pritej të vepronte me kujdesin e duhur dhe në përputhje me obligimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Për të kuptuar shkallën e detyrave të tij në mjedisin pas konfliktit ishte e nevojshme të njëhej me përmbajtjen aktuale të të gjitha dosjeve të lëndëve në mënyrë që të drejtat e atyre që ishin të përfshirë të ruheshin. Kjo duket se nuk ka ndodhur në secilin rast, në dëm të viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut siç është ankuesja.
58. Bazuar në atë që u paraqit më sipër, Paneli do të ftojë shefin e Misionit të kryejë një rishikim të plotë të të dhënave hetimore dhe prokuroriale të Misionit gjatë kohëzgjatjes së tij për të pasur një kuptim të qartë, të plotë dhe të informuar mirë të shkaqeve dhe rrethanave të paafësisë së tij për të përmbushë këtë pjesë të mandatit të vet në mënyrë efektive dhe në një mënyrë në përputhje me obligimet e veta ndaj të drejtave të njeriut. Kjo duhet të ndihmojë shefin e Misionit të adresojë trashëgiminë e jashtëzakonshme të të drejtave të njeriut të këtyre dështimeve me qëllim që të sigurojë që Misioni të jetë në gjendje t'i korrigjojë ato shkelje të të drejtave të njeriut që ka kryer gjatë ekzistencës së tij.

#### **Etiketimi ligjor dhe të drejtat e njeriut**

59. Në parashtrimet e tij (shih më lart paragrafin 56), shefi i Misionit sugjeroi që NjHKL-ja e EULEX-it t'i jepte përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturve 'dosje të krimeve të luftës' ndaj 'dosjeve të personave të zhdukur'. Paneli thekson që dallimi i propozuar nuk mund të konsiderohet këtu substancial. Së pari, dallimi është ligjërisht artificial: raste të zhdukjes me forcë ose personave të zhdukur mund të përbëjnë krim lufte dhe janë ndjekur penalisht në kategori të ndryshme të krimeve të luftës që prej të paktën Luftës së Dytë Botërore. Shih p.sh., *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Vendimi i Pranueshmërisë dhe Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët. 86-92. Paneli vëren në atë aspekt se ishte njësia e krimeve të luftës e Misionit që merrej me raste të tilla, duke e bërë të qartë se, edhe nga pikëpamja institucionale, nuk kishte asnjë konflikt midis personave të zhdukur dhe rasteve të krimeve të luftës.
60. Së dyti, nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dallimi është i pakuptimtë. Obligimi për të hetuar që lind në një rast të tillë nga nenet 2 (pjesë procedurale) dhe 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk lidhet me karakterizimin ligjor të dhënë për aktin sipas ligjeve vendore (ose ligjit ndërkombëtar). Me fjalë të tjera, nga këndvështrimi i detyrimeve të tij për të drejtat e njeriut, Misioni nuk ishte më pak i obliguar të hetojë një rast të tillë nëse e konsideronte atë si një rast të krimeve të luftës 'apo si rast të personit të zhdukur'. Shih, p.sh., Konventën Ndër-Amerikane për Zhdukjen e Detyruar të Personave (1994); Asambleja e Përgjithshme e KB-së, Deklarata për Mbrojtjen e Të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, UN Doc A/RRES/47/133, 18 dhjetor 1992 (këtu e tutje Deklarata e 1992 për Zhdukjen me Forcë), art. 1(1); Këshilli Ekonomik dhe Social i KB, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me Forcë ose të Pavullnetshme, Dokumenti i KB-së i E/CN. 4/1996/38, 1 janar 1996; Komiteti i KB-së i të Drejtave të Njeriut, Komentit i Përgjithshëm CCPR Nr. 6: neni 6 (E drejta për jetë), 30 prill 1982 (këtu e tutje Komentit i Përgjithshëm Nr. 6), s. 4; Asambleja e Përgjithshme e KB-së, Personat e Zhdukur, UN Doc A/RES/33/173, 20 dhjetor 1978 (në tekstin e mëtejshëm UN

Doc A/RES/33/173); Asambleja e Përgjithshme e KB-së, *Pyetja e Zhdukjeve të Detyruara ose të Pavullnetshme*, UN Doc A/49/610/Add.2, 23 dhjetor 1994.

61. Për më tepër, Paneli vëren se përparësia e pretenduar dhënë rasteve të "personave të zhdukur" nuk duket se mbështetet nga prova konkrete. Në vend të kësaj, është e qartë nga rastet që janë parashtruar në Panel se rastet që kanë të bëjnë me persona të zhdukur kanë dështuan të hetoheshin siç duhet, qofshin të etiketuara "krime lufte", "persona të zhdukur", "aktivë" ose "të mbyllur". Në këtë kuptim, dështimi duket se është rezultat i dështimit për t'i dhënë përparësi këtij lloji të rasteve e jo se është shkaktuar nga etiketime ligjore joadekuate dh përfundimisht jorelevante.
62. Paneli thekson se gjetjet e ngjashme me ato të lartpërmendura më lart tashmë janë bërë në një numër të lëndëve të kaluara parashtruar në Panel. Megjithatë, Misioni ka vazhduar të sugjerojë se karakterizimi ligjor i rastit do të mbështeste dështimin e tij për të përmbushur obligimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Jo, nuk e mbështet, prandaj Paneli fton Misionin që të mos i përsërisë këto parashtresa në të ardhmen.

### **Mungesa e provave të një hetimi para-ekzistues**

63. Në parashtresat e tij lidhur me pranueshmërinë e kësaj ankese (shih më lart par. 39), Misioni ka pranuar se,

“[...] nuk ka pasur asnjë përfshirje të Misionit në hetimin e vrasjes së Staniša Stojanović-it”.
64. Misioni vuri në dukje se kishte disa baza të të dhënave në Microsoft Access që iu dorëzuan Misionit nga UNMIK-u. Këto përfshinin një për dosjet policore të “krimeve të luftës” dhe një tjetër për rastet e “personave të zhdukur”. Rasti i Staniša Stojanović ishte përmendur në bazën e të dhënave për rastet e “personave të zhdukur”, por dosja ishte e zbrazët për faktin se ai ka vdekur.
65. Prandaj, Misioni në mënyrë kategorike pretendon se nuk ka pasur njohuri se rasti ishte në proces e sipër të një hetimi penal.
66. Shpjegimet e Misionit nuk bindin për arsye të tjera. Pavarësisht nëse UNMIK-u ka qenë apo jo i angazhuar në një hetim të vazhdueshëm për vrasjen dhe vdekjen e Staniša Stojanović në kohën e dorëzimit të dosjeve të rastit tek EULEX-i, vetë Misioni kishte informacionin që kishte kërkuat për të arsyetuar hapjen e një hetim për vdekjen e dhunshme të Staniša Stojanović. Përgjegjësia e tij për të hetuar buronte drejtpërdrejt nga mandati i tij – nuk varej nga pikëpamja apo konsiderata e UNMIK-ut. As nuk varej nga UNMIK-u që ta konsideronte atë rast si të hapur apo të mbyllur.
67. Prandaj, duke pasur në dorë Raportin e Hetimit Ante-mortem të vitit 2005, përderisa kishte një mandat ekzekutiv deri në mes të qershorit 2018, Misioni ishte në gjendje të hetonte rastin.
68. Nga dosja është e qartë se nuk janë bërë përpjekje të tilla. Për më tepër, Misioni mund t'i kushtonte vëmendje këtij rasti edhe pasi kjo ankesë iu komunikua ShM-së në vitin 2016. Përkundrazi, Misioni u përqendrua që të ankohej për parregullsitë e procesit të transferimit të dosjeve e jo për aktivitet konstruktive të orientuara kah viktimat. Ndonëse këto te meta do të kishin qenë relevante për të vlerësuar se si dhe sa kohë iu desh Misionit që të vepronte, ato nuk mund të arsyetojnë apo shpjegojnë dështimin e tij për të vepruar.

69. Misioni nuk mund të përdorë mos kryerjen e hetimit duke u justifikuar me mungesën e informacionit. Informacioni lind nga hetimi, jo anasjelltas. Prandaj ishte përgjegjësi e Misionit që të përpqej të merrte një informacion të tillë. Përderisa obligimet e tij në këtë drejtim ishin sipas mjeteve e jo sipas rezultateve, nga procesverbali është e qartë se Misioni as që ishte përpjekur të kërkonte dhe të merrte informacione, përveç asaj që kishte trashëguar nga UNMIK-u.
70. Arsyetimi i përfshirë në parashtresat e ShM-së dëshmon se Misioni nuk e ka kuptuar faktin që përderisa dosjet e lëndëve të dorëzuara nga UNMIK-u kanë mbetur në posedim të EULEX-it, Misioni ka mbetur i angazhuar në lidhje me ato lëndë, pra Misioni ka qenë kompetent dhe përgjegjës për të nisur ose vazhduar veprimin hetimor, deri në momentin kur autoritetet e Kosovës të ishin informuar zyrtarisht për ato raste dhe për dosjet e transferuara ose deri në përmbushjen e të gjitha obligimeve të tij në lidhje me atë rast.
71. Paneli thekson se obligimet për të drejtat e njeriut nga ana e Misionit nuk janë të kufizuara në bazë të rrethanave të veçanta. Obligimet që dalin nga nenet 2 dhe 3 të Konventës për të hetuar raste të tilla duhet të realizohen pavarësisht nga cilësia e provave. Për më tepër, siç u përmend më lart, kishte prova mbi të cilat ndonjë hetim mund të kishte filluar. Do të ishte absurde nëse ndonjë autoritet do të mund të lironte veten nga obligimet hetimore për shkak të mungesës së informacionit para se të kishte filluar hetimin. Marrja e informacionit është vetë pika e një hetimi. Nëse pas një përpjekjeje efektive dhe të arsyeshme për të hetuar në përpjesëtim me rëndësinë e të drejtave në fjalë nuk mund të merret asnjë informacion ose mund të merret informacion i pamjaftueshëm, autoritetet nuk mund të mbahen përgjegjëse për dështimin që të gjenin më shumë. Megjithatë, këtu nuk është kështu. Misioni as që është përpjekur apo as që kishte filluar të kryente ndonjë hetim. Prandaj, ai nuk mund të përdor mungesën e informacionit (adekuat ose të mjaftueshëm) si bazë për dështimin e tij për të filluar ndonjë hetim.

#### **Njoftim i të afërmeve të personit të zhdukur**

72. Misioni nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim bindës rreth mos informimit të të afërmeve të të zhdukurit në këtë rast në lidhje me veprimet e tij ose vendimin për të mos hetuar këtë rast.
73. Në këtë kontekst, cilësia apo mjaftueshmëria joadekuate e supozuar e informacionit nuk kishte asnjë ndikim në obligimin e Misionit për të informuar të afërmit. Me ose pa një informacion të tillë, Misioni është dashur të informonte të afërmit e Staniša Stojanović-it në lidhje me veprimet dhe përpjekjet e tyre. Misioni nuk e ka bërë këtë dhe nuk ka dhënë arsye bindëse për atë dështim.
74. Bazuar në atë që u paraqit më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka dështuar të përmbushë obligimin e tij sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe nenit 3 të Konventës për të mbajtur të afërmit e ngushtë të Staniša Stojanović të informuar në mënyrë të përshtatshme për rrjedhën e veprimit të ndërmarrë për të hetuar zhdukjen dhe vdekjen e tij.

#### **Lidhur me nenin 3 të Konventës**

75. Paneli përmend praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me rrethanat në të cilat e drejta për të mos iu nënshtuar trajtimit çnjerëzor mund të shkelet në rastet e zhdukjes me forcë. Në aktgjykimin e tij në *Basayeva dhe të tjerët kundër Rusisë* (nr. 15441/05 dhe 20731/04, Aktgjykimi i 28 majit 2009, par. 159), Gjykata vërejtë se,

“Çështja nëse një anëtar i familjes së një “personi të zhdukur” është viktimë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 do të varet nga ekzistenca e faktorëve të

veçantë që i japin vuajtjes së aplikantëve një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional që mund të konsiderohet i pashmangshme tek të afërmit e një viktime të një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut. Elementët përkatës do të përfshijnë afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, shkallën në të cilën anëtari i familjes ishte dëshmitar i ngjarjeve në fjalë, përfshirja e anëtarit të familjes në përpjekjet për të marrë informacion për personin e zhdukur dhe mënyrën në të cilat autoritetet iu janë përgjigjur atyre pyetjeve. Gjykata do të theksonte më tej se thelbi i një shkeljeje të tillë nuk qëndron kryesisht në faktin e “zhdukjes” së familjarit, por më tepër ka të bëjë me reagimet dhe qëndrimet e autoriteteve ndaj situatës kur ajo iu vihet në vëmendjen e tyre. Është veçanërisht në lidhje me këtë të fundit që një i afërm mund të pretendojë drejtpërdrejt se është viktimë e sjelljes së autoriteteve (shih *Orhan kundër Turqisë*, nr. 25656/94, § 358, 18 qershor 2002, dhe *Imakayeva kundër Rusisë*, nr. 7615/02, § 164, 9 nëntor 2006”).

76. Në rastin aktual, bashkëshorti i ankueses, Staniša Stojanović, ishte zhdukur në verën e vitit 1999. Edhe pse Misioni në një moment mori informacione për vdekjen e bashkëshortit të ankueses, nuk i është ofruar ankueses asnjë lloj informacioni, e as ndonjë shpjegimin apo zotim se çështja do të hetohej nga Misioni.
77. Bazuar në këtë sekuençë të ngjarjeve, do të ishte e arsyeshme që ankuesja të supozonte se bashkëshorti i saj është ende i zhdukur dhe se nëse ai do të identifikohet si i vdekur, do të hapet një hetim. Në fakt vetëm përmes komunikimit në mes të Panelit dhe shefit të Misionit tani është bërë e qartë se ka pasur informacione për vdekjen e tij, por jo hetime të vazhdueshme për zhdukjen dhe vrasjen e Staniša Stojanović-it.
78. Në këto rrethana, Paneli konsideron se mospërfillja e plotë nga ana e Misionit ndaj obligimit të tij për të kryer hetim për zhdukjen dhe vdekjen e Staniša Stojanović-it dhe qasjes së shkujdesur të dukshme me të cilën ata u morën me këtë rast, përbën pikërisht faktorë të tillë të veçantë që e bën të nevojshme konkluzionin se mosveprimi i Misionit në lidhje me ankuesen përbën shkelje të së drejtës së saj për mos t’iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor, siç garantohet me nenin 3 të Konventës. Siç u theksua në një vendim të Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, “*shkelja e integritetit mendor dhe moral të atyre të afërmeve është pasojë e drejtpërdrejtë e zhdukjes së tij me forcë. Rrethanat e zhdukjeve të tilla shkaktojnë vuajtje dhe ankth, përveç ndjenjës së pasigurisë, zhgënjimit dhe pafuqisë përballë dështimit të autoriteteve publike për të hetuar*” (shih çështjen *Blake kundër Guatemalës*, Aktgjykimi i 24 janarit 1998, Meritat, par. 114).

#### **Vazhdimi i mandatit ekzekutiv**

79. Misioni ka përsëritur një parashtrim që e kishte bërë tashmë në rastet e mëparshme se ai është i gatshëm të ndihmojë nëse informacione të reja në lidhje me të afërmin e ankueses vihen në dispozicion.
80. Paneli më parë ka shprehur konsideratën e tij rreth parashtresave të tilla, në veçanti, pasi që mund t’i jepte ankueses përshtypjen se Misioni është ende i përfshirë në këtë rast, e që në fakt nuk është. Një deklaratë e tillë për më tepër është në kundërshtim me qasjen e Misionit duke insistuar se nuk mund të bëjë asgjë në ato raste për shkak të mungesës së mandatit ekzekutiv dhe për shkak të respektit të pavarësisë së autoriteteve të Kosovës. Për më tepër, siç është theksuar tashmë, Misioni e di se pa një hetim, një informacion i tillë nuk ka gjasa të bëhet i disponueshëm. Prandaj është e nevojshme që Misioni t’u t’iu jep kuptim fjalëve të veta. (Shih: *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, par. 60-64.).

81. Paneli është ende në pritje të një përgjigjeje ndaj ftesës së tij që shefi i Misionit duhet të marrë parasysh miratimin e një strategjie të plotë dhe efektive për Misionin që përfundimisht ta bëjë çështjen e të zhdukurve prioritet të Misionit.
82. Paneli do ta ftone Misionin që të përmbahet nga përsëritja e 'gatishmërisë së tij për të ndihmuar', e cila tashmë është regjistruar nga Paneli dhe e cila nuk ofron asnjë formë të mjetit juridik për ankuesen, por përkundrazi mund të krijojë pritje të rreme në një situatë të vazhdueshme vuajtjeje për shkak të zhdukjes së pazbardhur të një të afërmi të saj.

### **Konkluzionet dhe gjetjet**

83. Bazuar në atë që u paraqit më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe 3 të Konventës duke mos e hetuar zhdukjen e të afërmit të saj dhe duke mos i siguruar asaj ose të afërmit të tjerë të ngushtë ndonjë informacion në lidhje me këtë rast. Duke marrë parasysh seriozitetin e të drejtave në fjalë, peshën e dështimit të Misionit dhe kohëzgjatjen në fjalë, shkelja duhet të konsiderohet tejet e rëndë. Gjithashtu shkelja është duke vazhduar.
84. Prandaj, shefi i Misionit ftohet të ndërmarrë hapa dhe masa që janë në përpjesëtim me këtë fakt, siç rekomandohet më poshtë.
85. Bazuar në ato gjetje, Paneli e konsideron të panevojshme të bëjë gjetje shtesë në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës. Sidoqoftë, është mjaft e dukshme që sjellja e Misionit ka pasur një efekt negativ në të drejtat e ankueses siç mbrohen nga ato dispozita. Në vlerësimin e tij në lidhje me atë se cilat masa ose hapa duhet të ndërmerren për të korrigjuar shkeljet të evidentuara në këtë vendim, shefi i Misionit ftohet të sqarojë këtë fakt.
86. Në këtë kontekst, Paneli fton Misionin që t'i kushtojë vëmendje të duhur domosdoshmërisë dhe efektivitetit të ngritjes së vazhdueshme të argumenteve dhe pikave të njëjta, të cilat tashmë veçse janë trajtuar në rastet e mëparshme. Paneli e fton Misionin që t'i ankorojë parashtrirat e tij të ardhshme në një analizë të aktiviteteve të Misionit që shihet nga perspektiva e obligimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut.
87. Paneli gjithashtu fton shefin e Misionit që të merr parasysh domosdoshmërinë që Misioni ka të kryejë një rishikim transparent dhe efektiv të aktiviteteve dhe trashëgimisë së tij – në veçanti, nga pikëpamja e obligimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut – në mënyrë që të nxjerrën mësim nga përvoja e Misionit për angazhime të tilla në të ardhmen.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**GJEN** se ankesa është e pranueshme në përputhje me nenet 2 (pjesë procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

**GJEN** se Misioni i ka shkelur të drejtat e ankuesit të garantuara me nenin 2 (pjesë procedurale) dhe me nenin 3 të Konventës;

**GJEN MË TUTJE** se shkeljet janë serioze dhe të vazhdueshme dhe se, për këtë arsye, ato kërkojnë zbatimin e masave korrigjuese në proporcion me to;

**I BËN THIRRJE** shefin e Misionit të zbatojë masa korrigjuese në proporcion me peshën e shkeljeve në fjalë;

**KONSTATON** se nuk ka nevojë të bëjë gjetje mbi meritat në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës;

**FTON SHEFIN E MISIONIT** që posaçërisht të shqyrtojë interpretimin e dhënë aktualisht për natyrën dhe fushën e obligimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe për të marrë në konsideratë me sa vijon:

1. Paneli fton shefin e Misionit të konsiderojë zyrtarisht pranimin e shkeljes së të drejtave të ankuesit nga Misioni dhe të ofrojë korrigjim adekuat për të.
2. Paneli fton Misionin që të vazhdojë të kërkojë dhe identifikojë zyrën e prokurorisë, përgjegjëse për hetimin e këtij rasti.
3. Paneli më tutje fton Misionin që të pyesë prokurorin kompetent nëse çështja është duke u hetuar dhe, nëse jo, pse.
4. Paneli fton Misionin të marrë parasysh se çfarë hapa konkretë dhe domethënës mund të ndërmerret Misioni për të kontribuar në ecjen përpara të hetimit të rasteve të zhdukjeve me forcë/personave të zhdukur. Paneli është i gatshëm të vazhdojë të angazhohet me shefin e Misionit në përpjekjen për të gjetur zgjidhje për atë qëllim. Megjithatë Paneli dëshiron të theksojë se hapat e ndërmerret deri më tani nga Misioni janë jo adekuate nga pikëpamja e obligimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe jo të afta për të kontribuar në mënyrë kuptimplote në zgjidhjen e atyre rasteve. Është koha e duhur që Misioni të bëjë më shumë.
5. Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes se cilat mjete juridike janë ende në dispozicion të Misionit në një rast siç është rasti i tanishëm, ku Misioni është gjetur të ketë shkelur të drejtat e një të afërmi të një personi të zhdukur dhe të informojë Panelin për konkluzionet e tij.
6. Paneli fton Misionin të shpërndajë këtë vendim tek:
  - i. Personeli përkatës brenda Misionit;
  - ii. Zyrtarët përkatës të Bashkimit Evropian që kanë përgjegjësi për Kosovën, rajonin e Ballkanit, misionet për Politika të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ose çështje të të drejtave të njeriut; dhe

**FTON** Misionin që t'i raportojë Panelit në lidhje me rekomandimet e mësipërme sa më shpejt që të jetë e mundur deri më datën 15 nëntor 2022.

Për Panelin,

Snježana BOKULIĆ  
Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit

Petko PETKOV  
Anëtar

